



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 91

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS NË SHKODËR, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrativ me:

**SUBJEKT:** Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për Bashkinë Shkodër

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Shkodër, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 18.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike të kryera nga bashkia Shkodër, të cilat rezultojnë të paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. *“Kënaqësi të prisja gjimnazistët e shkollës jo publike “Zani i Shkodrës”, të cilët u njohën nga afër me punën e administratës dhe projektet tona për zhvillimin e Shkodrës. Prej ditës së parë të marrjes së detyrës, sfida ime kryesore ka qënë ajo e ndërtimit të një bashkie të hapur për qytetarët, e ku zëri i tyre të dëgjohet.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=569906988489411&set=pcb.569908455155931>

*Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.*

2. *“Në 74-vjetorin e lindjes, pata kënaqësinë të uroja dhe njëkohësisht t’i dorëzoja vlerësimin e “Mirënjohjes”, ish mesfushorit të Vllaznisë Françesk Ndoja”.*

Link:<https://www.facebook.com/photo?fbid=711488567031910&set=pcb.711489657031801>

*Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator, si dhe është publikuar në 2 (dy) media.*

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 20.2.2023, bashkisë Shkodër i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 28.2.2023, bashkia Shkodër nëpërmjet postës elektronike ka dërguar bashkëlidhur shkresën nr. 2985 prot. datë 28.2.2023, ku ndër të tjera bën me dije se:

Në lidhje me indicien e parë: “Takimi është zhvilluar me gjimnazistët e shkollës jo publike “Zani i Shkodrës”. Ky aktivitet është organizuar nga shkolla “Zani i Shkodrës”.

Në lidhje me indicien e dytë: “Takimi është zhvilluar me rastin e 74 vjetorit të lindjes së ish sportistit Francesk Ndoja. Ky aktivitet është organizuar nga Klubi i Futbollit Vllaznia”.

Në përfundim të hetimit administrative rezultoi se bashkia Shkodër nuk është organizatore e aktiviteteve të sipër përmendur, për pasojë në referim të legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportimin e aktivitetit nuk rëndon mbi këtë institucion. Ky detyrim rëndon mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Shkodër, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

#### **V E N D O S :**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Shkodër.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**